Koment

Udhëtimi pa viza dhe përfitimet e garës në Ballkan

Komisioni Evropian është aktualisht në bisedime me Tajvanin për heqjen e vizave, duke treguar se njohja ndërkombëtare dhe politika e vizave janë të dy çështje mjaft të ndara. Pra, ka shumë arsye për takimin e ministrave të jashtëm të BE-së, më 7 dhe 8 dhjetor, të ftojë zyrtarisht Komisionin për hartimin e një udhërrëfyesi të vizave për Kosovën, duke e bërë të qartë se kjo do të jetë pa paragjykim të statusit të saj

Gerald Knaus dhe Aleksandra Stiglmayer

Vendimi i javës së kaluar i BE-së për t'i aprovuar udhëtimet pa viza për maqedonasit, malazezët dhe serbët ka sjellë festime në rajonin, i cili shumë shpesh ishte i bllokuar në errësirë. "Evropa hap dyert e saj", njoftoi një e përditshme e Malit të Zi. "Muri i Shengenit ka rënë," deklaroi transmetuesi publik i Serbisë. Një linjë ajrore serbe ofroi menjëherë fluturime promovuese në vendet e Shengenit nën moton "Evropa për të gjithë ne".

Pas gati dy dekadave të izolimit, ky është një lajm i madh se qytetarët e këtyre tri vendeve do të jenë në gjendje të udhëtojnë pa viza në zonën Shengen nga data 19 dhjetor. Kërkesa për vizë ishte kundërproduktive për anëtarët në pritje të BE-së. Kjo ka penguar biznesin dhe ka krijuar një pengesë psikologjike që i bëri qytetarët skeptikë për një të ardhme evropiane.

BE-ja gjithashtu është duke marrë shumë në kthim. Si kusht për udhëtimet pa viza, vendet e Ballkanit kishin për të kryer reformat me ndikim të gjerë në fushat e kontrollit të kufirit, siguria e pasaportave dhe lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migracionit të paligjshëm. Këto masa e bëjnë të tërë Evropën më të sigurt.

Sidoqoftë, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova ende nuk janë pjesë e këtij grupi të lumtur. Me statusin e saj ndërkombëtar ende të diskutueshëm, Kosova mbetet çështja më e nxehtë. Deri para pak kohësh nuk ka pasur perspektivë të liberalizimit të vizave për Kosovën. Por në tetor të vitit të kaluar Komisioni premtoi një "dialog të vizave", me perspektivën e liberalizimit të mundshëm, e kushtëzuar nga reformat e nevojshme. Megjithatë, për dallim nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, BE-ja ende nuk lansoi as edhe një udhërrëfyes të vizave i cili përcakton të gjitha reformat që Kosova do të duhej të ndërmarrë. Procesi u la i paqartë. Ka arsye të dukshme për të anashkaluar procesin. Komisioni nuk ka dashur të armiqësojë ata anëtarë të BE-së që kanë refuzuar të njohin pavarësinë e Kosovës dhe të cilët mund të jenë të shqetësuar se një dialog për viza arrin të nënkuptohet si njohje, ose atyre që kanë frikë se ajo do të hapë portat për emigracionin e paligjshëm.

Këto shqetësime nuk janë të justifikuara. Së pari, përvoja me vendet e tjera të Ballkanit tregon se një proces i qartë i përqendruar në udhërrëfyes me objektiva të përcaktuara ka prodhuar reformat më të shpejta. Ndër të tjera, kjo kërkon një seri të tërë masash të ashpra për kontrollin e migracionit, duke përfshirë edhe marrëveshjet e ripranimit e cila i detyron vendet që të kthejnë mbrapsht cilindo qytetar që banon në BE në mënyrë të paligjshme. Përveç kësaj, Kosova është mikpritëse e EULEX-it, misioni i sundimit të ligjit më i madhi në historinë e BE-së. EULEX-i është duke u përpjekur për të arritur shumicën e reformave të njëjta të cilat do të përcaktohen në një udhërrëfyes. Kushtëzimi në procesin e liberalizimit të vizave në masë të madhe do të rrisë perspektivat e saj të suksesit.

Së dyti, liberalizimi i vizave për Kosovën mund të jetë krejtësisht status neutral. Në fund të fundit, Komisioni është aktualisht në bisedime me Tajvanin për heqjen e vizave, duke treguar se njohja ndërkombëtare dhe politika e vizave janë të dy çështje mjaft të ndara. Pra, ka shumë arsye për takimin e ministrave të jashtëm të BE-së, më 7 dhe 8 dhjetor, të ftoj zyrtarisht Komisionin për hartimin e një udhërrëfyesi të vizave për Kosovën, duke e bërë të qartë se kjo do të jetë pa paragjykim të statusit të saj.

Ministrat gjithashtu mund të përshpejtojnë procesin e heqjes se kërkesës për vizë për Shqipërinë dhe Bosnjën. Kur BE-ja në korrikun e kaluar propozoi që të hiqen vizat për Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, Shqipëria dhe Bosnja ishin ende duke i zvarritur këmbët e tyre mbi kushtet. Që atëherë, megjithatë, ata kanë bërë përparim të madh dhe së shpejti do të plotësojnë të gjitha kushtet. Pyetja atëherë nuk do të ishte se a do të kualifikohen për udhëtim pa viza vitin e ardhshëm por kur vitin e ardhshëm?



Çdo gjë mund të fitohet nga një vendim i hershëm për të ruajtur vrullin dhe për të siguruar se shqiptarët dhe boshnjakët nuk ndihen të diskriminuar. Ministrat e jashtëm të BE-së mund të përcaktojnë një datë të synuar për fillimin e udhëtimit pa viza para pushimeve të verës, maj osë qershor 2009.

Kjo do t'i kërkonte Komisionit të organizojë misionet e vlerësimit - mbase do të jenë tre për secilin vend - sa më shpejt të jetë e mundur. Dy të parët janë planifikuar tashmë për në dhjetor, gjë që është inkurajuese. Duke supozuar një rezultat pozitiv të misionit, Komisioni, Parlamenti dhe Këshilli do të duhet të punojnë me shpejtësi për të ndryshuar Rregulloren përkatëse. Ndërkohë, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia duhet të sigurohen se udhëtimi pa viza për Ballkanin mbetet një histori suksesi. Ata duhet të vazhdojnë të shkojnë përpara me reformat e udhërrëfyesit, duke mos lënë asnjë dyshim për angazhimin e tyre të vazhdueshme për të përmbushur standardet e BE-së.

Ata mund edhe të bëjnë publike përfitimet pozitive të lirisë së vizave. A është në rritje numri i studentëve të Ballkanit Perëndimor në BE? A është në lulëzim tregtia me BE-në? A ka më shumë ngjarje ndërkulturore? Procesi i liberalizimit të vizave ka qenë një shembull i shkëlqyer i pushtetit të butë të BE-së në punë. Ka pasur kushte shumë të qarta, një proces rigoroz me pikësynime dhe afate dhe një lëng karote i arritshëm në fund. Kjo krijoi një konkurrencë shumë të shëndetshme midis pesë vendeve pjesëmarrëse. Kur Shqipëria dhe Bosnja e kuptuan verën e kaluar se ata ishin mbetur prapa fqinjëve të tyre, ato dyfishuan përpjekjet e tyre.

Këtu janë mësimet që mund të përdoren për procesin e zgjerimit më të gjerë të Ballkanit. Trajtimi i të gjitha vendeve njësoj në një proces të vetëm, por shpërblyer ata për përmbushjen objektive dhe strikte, në mënyrë të drejtë, është mënyra më e mirë për të nxitur përpjekjet kombëtare për të përmbushur kriteret e kërkuar të pranimit.

Konkurrenca transparente e bazuar në merita bën mrekulli, madje edhe në Ballkan. Kjo është lloj i rivalitetit të Ballkanit që qytetarët e rajonit - dhe të gjithë Evropës - të mund të përfitojnë. Në fakt, nuk mund të ketë limit për këtë.

(Gerald Knaus është udhëheqës dhe Aleksandra Stiglmajer analiste e lartë e Iniciativës Evropiane për Stabilitet, një institut hulumtues që ka ndjekur nga afër procesin e liberalizimit të vizave për Ballkanin Perëndimor. Ky vështrim është botuar edhe në "EU Observer". Më shumë informata mund të gjenden në: www.esiweb.org/whitelistproject)

---

jatë, anekënd globit. Një nga qëllimet kryesore të konferencës do të jetë të gjenden mekanizma për financimin e teknologjive të pastra dhe për financimin e shteteve në zhvillim, të cilat duhet të pajisen për t'i takuar standardet e vendosura tashmë nga shtetet evropiane, si dhe nënshkruesit e Protokollit të Kyotos.

Të gjithë pajtohen se lufta kundër ndryshimeve të klimës është një garë serioze, që njerëzimi nuk guxon ta humbë assesi. Në këtë garë garojnë lepuj, breshka dhe ata që nuk duan të nisen – janë ngulitur dhe nuk e ndiejnë krismën e startit. Ata që nuk duan të futen në garë janë kontribuesit më të mëdhenj të këtij rreziku global. Janë India dhe Kina, të cilat do të jenë në konferencë dhe thuhet se do të sjellin një ofertë, ose më mirë të themi një shpresë se do të futen në garë. Por s'do të vraponin edhe aq shpejt, por do të futeshin në garë. Le të shohim se çka do të thonë dhe cilat detyrime do t'i marrin nga kjo konferencë.

SHBA-ja, edhe pse zyrtarisht nuk e ka nënshkruar Kyoton, tashmë i ka vendosur caqet për reduktim të emisionit të gazrave të serës, të cilat edhe nuk janë aq larg caqeve evropiane. SHBA-ja kurrë nuk e ka dashur rolin e breshkës në zhvillimet botërore. Gjithmonë ka dashur të jetë lepur, por ja që në këtë rast rolin e lepurit që vrapon drejt shpresës për njerëzimin e ka marrë Evropa. Presidenti Obama do të jetë në Kopenhagë më 18 dhjetor dhe do ta shpalosë vendimin amerikan – që shpresojmë të gjithë do të sjellë më shumë shans në këtë garë me kohën. SHBA-ja i detyrohet globit për këtë, sepse është një ndër ndotësit më të mëdhenj.

Po ku është Kosova këtu? Se nuk jemi lepuj, ka kohë që e kemi dëshmuar. Por as breshkë nuk jemi. Nuk po na lënë të jemi bile breshkë, kishin me thanë ata që dinë pak më shumë për këtë proces. Ne nuk jemi këto ditë në Kopenhagë. Nga 34.000 pjesëmarrës, me sa di unë nuk do të jetë asnjë kosovar, ose shumë shumë pak – disa të rastit ndoshta! E pse do të duhej të jemi më afër këtij procesi? Do të përmend vetëm tri arsye:

E para, Kosova është një "bombë karboni". Ajo ka 14 miliardë tonë linjit që, nëse digjen, mund të prodhojnë një sasi enorme të dyoksidit të karbonit, të cilin janë mbledhur ta luftojnë në Kopenhagë. Asnjë vend i rajonit nuk është potencialisht më i rrezikshëm se ne.

E dyta, Kosova ka nevojë për energji, dhe është normale që planifikon që të "kontribuojë" pak në këtë avari të përgjithshme, duke djegur të paktën edhe gjysmë milioni linjit në 40 vitet e ardhshme. Me këtë investim ajo definitivisht do ta fuste veten në radhë me Kinën dhe Indinë, jo për nga sasia e emisionit të gazrave serë, por për mospërfillje të lëvizjeve globale në këtë drejtim. A do t'i lejohet Kosovës si vend evropian ta bëjë këtë, mendoj se jo – definitivisht Evropa s'do të na lejojë, nëse duam të jem pjesë e saj. Evropa vetëm sa ishte në gjumë, në vitet e kaluara, kur planifikoi së bashku me disa shtytës të tjerë të idesë së ndërtimit të mega – kapaciteteve energjetike me bazë djegjen e linjitit, nga i cili gjumë tashmë është zgjuar dhe është duke kontribuar në vendosjen e planeve zhvillimore fer dhe të pastra për Kosovën.

E treta, do të duhej që sa më parë të bëhemi pjesë e lëvizjeve pozitive ndërkombëtare – siç është kjo. Në Kopenhagë është duke u shkruar historia, dhe ne duhet të jemi aty. Nëse jo administrata shtetërore, sepse nuk i lejohet akoma, atëherë duhet të kemi përfaqësues të shoqërisë civile, medieve, asociacioneve të ndryshme profesionale. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, nga 34.000, që këto ditë do të jenë në Kopenhagë, janë nga këto qarqe. Shpresoj se të paktën Kopenhaga do të ndiqet me vëmendje, jo si një ngjarje interesante, dhe historike, por si një konferencë që do ta ndikojë definitivisht edhe zhvillimin e vendit tonë, dhe mbi të gjitha, ardhmërinë e fëmijëve tanë.

Nga shumë ngjarje të kualifikuara si historike nga vendimmarrësit tanë në disa muajt e kaluar do t'ju sugjeroja që ta fusin edhe këtë ngjarje në kalendarin historik të tyre. Thjesht, kjo konferencë e meriton të jetë pjesë e sloganeve qeveritare, edhe nëse nuk rimohet mirë me zgjedhjet lokale ose ngjarjet e tjera historike që jemi duke i kaluar.

(Autori është drejtor ekzekutiv i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur)

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.